



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0055

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “SRAHEP” SH.P.K., kundër mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1, me 07/03/2024, mori:

Vendim

1. Hedhet, si e palejuar ankesa e OE “SRAHEP” SH.P.K., me nr. 2024/0055, e datës 17/01/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1 i iniciuar nga Komuna e Prishtinës.

2. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 18.09.2023, “KK Prishtinë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit: 616-23-9889-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 600,000.00.

Me 10.01.2024, OE “SRAHEP” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 12.01.2024, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar kërkesën si të bazuar.

Me 17.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “SRAHEP” SH.P.K., me nr. 2024/0055 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit: 616-23-9889-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ SRAHEP ” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:
Pretendimet e OE ankues: “Autoriteti Kontraktues nuk e ka korrigjuar në platformën elektronike dosjen e tenderit dhe si pasojë nuk i ka ndryshuar kërkesat dhe dëshmitë për pjesëmarrje sikur është kërkuar në vendimin OSHP: 2023/0843 . Autoriteti Kontraktues ka vendosur vetëm përshkrimin e çmimit, si pasojë nuk dihet saktë se cilat kushte duhet të plotësohen për të marrë pjesë në tender pasi që ka bërë korrigjim të dosjes së tenderit por ndryshimet nuk i ka paraqitur në dosjen e re të tenderit. Mos vendosja e dosjes së re të tenderit në platformën elektronike paraqet shkelje të nenit 17 të Rregullores së Prokurimit 001/2022 konkretisht paragrafët 17.12 dhe 17.16 Duke mos e ndryshuar dosjen e tenderit Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka lënë në fuqi kushte të pjesëmarrjes të cilat janë diskriminuese dhe jo relevante me natyrën e prokurimit në fjalë edhe përkundër të konstatimit të panelit shqyrtues se Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet se kushtet e vendosura duhet të jenë relevante me natyrën e prokurimit. Andaj të pa kënaqur me veprimet e Autoritetit Kontraktues ne me datën 10.01.2024 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim, pasi që Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues duhet të bej përmirësimet në dosje të tenderit duke lejuar një tolerance të dimensioneve dhe peshave të inventarit, me përjashtim të pajisjeve që domosdoshmërisht për arsye objektive duhet të kenë dimensionet dhe peshën ashtu si është kërkuar. Lidhur me pohimin e ankuesit se AK ja ka përshtat specifikimet

teknike vetëm të një prodhuesi atëherë paneli shqyrtues mendon se 4/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK kjo paraqet shkelje të nenit 28 të LPP, kështu që AK është i obliguar që hartimin e Dosjes së Tenderit ta bëjë konform nenit 27 dhe 28 të LPP.

Kështu që, AK duhet të ndërmarrë masa të verifikojë këto konstatime të OE ankues dhe nëse këto janë të qëndrueshme atëherë ti bëjë këto përmirësime. Deri në përfundim të këtij vlerësimi paneli shqyrtues erdhi si pasojë e mos konstatimit të saktë të gjendjes nga ana e ekspertëve shqyrtues. Lidhur me pohimin e ankuesit sa i përket autorizimit nga prodhuesi apo dileri, paneli shqyrtues nuk pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues sepse kanë dallim autorizimet dhe deklaratat e konformitetit, gjë që nuk janë të njëjta, andaj, për panelin shqyrtues një kriter i tillë lidhur me këtë natyrë të furnizimit është kriter i rëndë dhe kufizon në masë të madhe konkurrencën. Edhe pse panelit shqyrtues ja ka bërë të qartë Autoritetit Kontraktues se autorizimi e kufizon në masë të madhe konkurrencën, pra kriteri është diskriminues AK ka vendosur përsëri kriterin e njëjtë duke ia ndërruar vetë vendet fjalëve në fjali por që esenca ka mbetur e njëjtë.

Andaj AK duhet të marrë masa për heqjen e autorizimit nga prodhuesi sikur ka konstatuar paneli shqyrtues. Po ashtu, paneli shqyrtues nuk pajtohet edhe në këtë rast me ekspertin shqyrtues sepse deri te ky konstatim eksperti shqyrtues ka ardhur si rezultat se kjo certifikate "synon të sigurojë që pajisjet mjekësore të jenë të sigurta dhe efektive për përdorimin e tyre të synuar", ndërsa, aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me inventar duke përfshirë në specifikacion, perde, ormana, karrika, etj. Kështu që AK duhet të veprojë konform nenit 51, paragrafi 1 i LPP, citat: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për të përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret e përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji". Autoriteti Kontraktues pas ankesës i ka korrigjuar disa specifika tek përshkrimi i çmimit dhe ka vendosur përshkrimin e çmimit në platformë, por edhe përkundër ndryshimeve që i ka bërë nuk e ka shtyrë afatin për dorëzimin e tenderit. Andaj me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 paragrafin 24.7 lidhur me paragrafin 24.5 pasi që pas ndryshimeve afati minimal që duhet të lihet nga data e ndryshimeve deri në datën e dorëzimit të tenderit është minimumi dhjetë (10) ditë, ndërsa AK ka dhënë një afat prej shtatë (7) ditëve nga data e ndryshimit të specifikave teknike në përshkrimin e çmimit.

Pra sikur shihet më lartë Autoriteti Kontraktues fare nuk ka marrë për bazë konstatimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së sa i përket kushteve të pjesëmarrjes andaj edhe me këtë rast ka bërë shkelje për mospërfillje të vendimit të OSHP-së sikur është përcaktuar në nenin 97 të Rregullores së Prokurimit. Duke u bazuar në atë që u tha më lartë me datën 10.01.2024 kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që të pezullon procedurën e prokurimit në fjalë, të rishqyrton kushtet e pjesëmarrjes në pajtim me konstatimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së dhe të heqni nga dosja e tenderit kriteret diskriminuese në mënyrë që të evitojnë shkeljet e legjislacionit të prokurimit të konstatuar nga paneli shqyrtues në mënyrë që të zbatohet vendimi i OSHP-së si dhe të ngarkojnë në sistem dosjen e korrigjuar të prokurimit në fjalë duke i qartësuar kushtet e pjesëmarrjes dhe të zgjasin afatin e dorëzimit të tenderit së paku 10 ditë nga data e ngarkimit në sistem të

dosjes së tenderit të korrigjuar.

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe me datën 12.01.2024 ka marrë vendim me të cilin ka aprovuar në tërësi të gjitha pretendimet ankimore duke konstatuar që pretendimet ankimore i referohen ekskluzivisht vendimit të OSHP-s me shenjën OSHP: 2023/0843 lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Gjithashtu kanë potencuar se respektimi i vendimeve të OSHP-s është detyrim ligjor i pa kontestueshëm në kuptim të nenit 97 paragrafi 97.1 RRPP dhe se është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore që i referohen ekskluzivisht vendimit të OSHP-s janë pretendime ankimore të bazuara. Por edhe pse ka aprovuar në tërësi kërkesën tone për rishqyrtim AK ka vazhduar me kushtet e njëjta të cilat OSHP i ka cilësuar si diskriminuese pasi që nuk e ka hequr nga kërkesa autorizimin e prodhuesit, ka kërkuar dëshmi të cilat nuk mund realizohen, pasi që tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2 pika 2 si dëshmi ka kërkuar CV të noterizuar gjë e cila nuk mund të bëhet pasi që noterët nuk e konsiderojnë si dokument që mund të noterizohet. Gjithashtu ka kërkuar që të paraqitet Kopja e Licencës së AKPPM-së si qarkullues me shumicë të pajisjeve medicinale e cila nuk është relevante me natyrën e prokurimit pasi që natyra e prokurimit është furnizimi me mobilje dhe inventar dhe jo pajisje medicinale sikur është paraqitur kërkesa më lartë. Kjo është bërë me qëllim të caktuar për ta favorizuar ndonjë O.E. të paracaktuar dhe për të diskriminuar O.E. tjerë konkurrent.

Andaj, Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që në përputhje me kompetencat e juaja të parapara në dispozitat e LPP-së si dhe në dispozitat e lartcekura të marrë masa ndaj AK-s për mos zbatimin e vendimit të OSHP-s me shenjën OSHP: 2023/0843, të urdhëroj Autoritetin Kontraktues që automatikisht të pezullon aktivitetin e prokurimit në fjalë deri sa të shqyrtohet ankesa jonë dhe të merret vendimi nga OSHP si dhe të urdhërohet Autoriteti Kontraktues të mënjanon kriteret diskriminuese teknike dhe ato të përzgjedhjes të cekura më lartë të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “SRAHEP” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 7, 27, 28, 51, 69 të LPP-së, si dhe nenin 4, 17, 24, 25, 97 i rregullores nr.001/2022 për prokurim publik.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: “Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Autoriteti Kontraktues nuk e ka korrigjuar në platformën elektronike dosjen e tenderit dhe si pasojë nuk i ka ndryshuar kërkesat dhe dëshmitë për pjesëmarrje sikur është kërkuar në vendimin OSHP: 2023/0843 . Autoriteti Kontraktues ka vendosur vetëm përshkrimin e çmimit, si pasojë nuk dihet saktë se cilat kushte duhet të plotësohen për të marrë pjesë në tender pasi që ka bërë korrigjim të dosjes së tenderit por ndryshimet nuk i ka paraqitur në dosjen e re të tenderit. Mos vendosja e dosjes së re të tenderit në platformën elektronike paraqet shkelje të nenit 17 të Rregullores së Prokurimit 001/2022 konkretisht paragrafët 17.12 dhe 17.16 Duke mos e

ndryshuar dosjen e tenderit Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka lënë në fuqi kushte të pjesëmarrjes të cilat janë diskriminuese dhe jo relevante me natyrën e prokurimit në fjalë edhe përkundër të konstatimit të panelit shqyrtues se Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet se kushtet e vendosura duhet të jenë relevante me natyrën e prokurimit. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues duhet të bej përmirësimet në dosje të tenderit duke lejuar një tolerance të dimensioneve dhe peshave të inventarit, me përjashtim të pajisjeve që domosdoshmerisht për arsye objektive duhet të kenë dimensionet dhe peshën ashtu si është kërkuar. Lidhur me pohimin e ankuesit se AK ja ka përshtat specifikimet teknike vetëm të një prodhuesi atëherë paneli shqyrtues mendon se kjo paraqet shkelje të nenit 28 të LPP, kështu që AK është i obliguar që hartimin e Dosjes së Tenderit ta bëjë konform nenit 27 dhe 28 të LPP. Kështu që, AK duhet të ndërmarrë masa të verifikoj këto konstatime të OE ankues dhe nëse këto janë të qëndrueshme atëherë ti bëjë këto përmirësime. Deri në përfundim të këtij vlerësimi paneli shqyrtues erdhi si pasojë e mos konstatimit të saktë të gjendjes nga ana e ekspertëve shqyrtues. Lidhur me pohimin e ankuesit sa i përket autorizimit nga prodhuesi apo dileri, paneli shqyrtues nuk pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues sepse kanë dallim autorizimet dhe deklaratat e konformitetit, gjë që nuk janë të njëjta, andaj, për panelin shqyrtues një kriter i tillë lidhur me këtë natyrë të furnizimit është kriteri i rëndë dhe kufizon në masë të madhe konkurrencën. Andaj AK duhet të merr masa për heqjen e autorizimit nga prodhuesi sikur ka konstatuar paneli shqyrtues. Po ashtu, paneli shqyrtues nuk pajtohet edhe në këtë rast me ekspertin shqyrtues sepse deri te ky konstatim eksperti shqyrtues ka ardh si rezultat se kjo certifikatë synon të sigurojë që pajisjet mjekësore të jenë të sigura dhe efektive për përdorimin e tyre të synuar, ndërsa, aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me inventar duke përfshirë në specifikacion, perde, ormana, karrika, etj. Kështu që AK duhet të veproj konform nenit 51, paragrafi 1 i LPP, citat: Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për të përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret e përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. Autoriteti Kontraktues pas ankesës i ka korrigjuar disa specifika tek përshkrimi i çmimit dhe ka vendosur përshkrimin e çmimit në platformë, por edhe përkundër ndryshimeve që i ka bërë nuk e ka shtyrë afatin për dorëzimin e tenderit. Andaj me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 paragrafin 24.7 lidhur me paragrafin 24.5 pasi që pas ndryshimeve afati minimal që duhet të lihet nga data e ndryshimeve deri në datën e dorëzimit të tenderit është minimumi dhjetë (10) ditë, ndërsa AK ka dhënë një afat prej shtatë (7) ditëve nga data e ndryshimit të specifikave teknike në përshkrimin e çmimit. Pra sikur shihet më lartë Autoriteti Kontraktues fare nuk ka marr për bazë konstatimet e Panelit Shqyrtues të OSHP sa i përket kushteve të pjesëmarrjes andaj edhe me këtë rast ka bërë shkelje për mospërfillje të vendimit të OSHP".

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes

dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0055/24, ndërsa me datë 02.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0055 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “SRAHEP” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0055 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1: “Pretendimi kryesor ankimor sipas ankesës nr.55/24 është se AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së nr.843/23, përmes të cilit vendim sipas OE ankues OSHP ka vlerësuar se dimensionet, peshat dhe kërkesat për autorizim të prodhuesit dhe ISO standardet janë kërkesa kufizuese.

Pas analizimit të shkresave të lëndës, dhe vendimit të OSHP-së nr.843/23, kemi gjetur se përveç korigjimeve të propozuara nga ekspertët shqyrtues për lejim të tolerancës +/-5% në dimensionet, paneli shqyrtues ka konstatuar se edhe kërkesat për autorizim të prodhuesit dhe kërkesa për certifikatave në rastin konkret janë kërkesa që në masë të madhe kufizojnë konkurrencën.

Vendimi I OSHP-së nr.843/23: “...Lidhur me pohimin e ankuesit sa i përket autorizimit nga prodhuesi apo dileri, paneli shqyrtues nuk pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues sepse kanë dallim autorizimet dhe deklaratat e konformitetit, gjë që nuk janë të njëjta, andaj, për panelin shqyrtues një kriter i tillë lidhur me këtë natyrë të furnizimit është kriter i

rëndë dhe kufizon në masë të madhe konkurrencën. Po ashtu, paneli shqyrtues nuk pajtohet edhe në këtë rast me ekspertin shqyrtues sepse deri te ky konstatim eksperti shqyrtues ka ardh si rezultat se kjo certifikatë "synon të sigurojë që pajisjet mjekësore të jenë të sigurta dhe efektive për përdorimin e tyre të synuar", ndërsa, aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me inventar duke përfshirë në specifikacion, perde, ormana, karrika, etj...".

Me qenë se me vendim të OSHP-de është konstatuar se autorizimi dhe certifikatat janë kritere që në masë të madhe kufizojnë konkurrencën, dhe këto kritere prapa gjenden në dosjen e korigjuar të AK-së, vlerësimi i ekspertit është se nuk është respektuar vendimi i OSH-së nr.843/23.

Bazuar në këto që cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara, dhe se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 97 të rregullores 001/2022 për prokurim publik.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “SRAHEP” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Lidhur me këtë ankesë për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit: 616-23-9889-1-1-1, OSHP ka pranuar email nga AK Komuna Prishtinë, më datë 31.01.2024. Duke deklaruar se "*Operatori ekonomik ankues “Srahep” Sh.P.K. me datë 10.01.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 06.12.2023. Tutje me datë 12.01.2024 zyrtari përgjegjës i prokurimit ka marrë vendim përmes të cilit e ka miratuar si të bazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues. Rrjedhimisht autoriteti kontraktues ka publikuar edhe B54 Formularin Standard për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilës janë bërë ndryshimet përkatëse në dosjen e tenderit. Vendimi për miratimin e kërkesës për rishqyrtim është arsyetuar ashtu që të gjitha pretendimet ankimore kanë qenë të referuara te konstatimet dhe të gjeturat sipas vendimit të Panelit Shqyrtues me nr. 2023/0843. Pra përveç që është miratuar kërkesa dhe është ndryshuar dosja e tenderit sipas kërkesës për rishqyrtim, me këtë rast është respektuar edhe vendimi përkatës i Panelit Shqyrtues në OSHP. Pavarësisht këtyre fakteve, operatori ekonomik ankues me datë 17.01.2024 ka parashtruar ankesë në OSHP përmes të*

cilave ka kërkuar që Paneli Shqyrtues të detyroj Autoritetin Kontraktues të ndryshoj kërkesat e dosjes së tenderit të cilat tanimë janë të ndryshuara për shkak të miratimit të kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues, Duke marrë parasysh të thënat më lartë, rrjedh se operatori ekonomik ankues nuk ka asnjë interes material apo rrezik të dëmtimit apo shkeljes së ndonjë të drejte, pasi që qëllimi për të cilën është parashtruar ankesa tanimë është realizuar nga vet autoriteti kontraktues. Përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP është përcaktuar se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Nga ky këndvështrim, operatori ekonomik ankues nuk është palë e interesuar në raport me ankesën e parashtruar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Tutje përmes nenit 108/A të LPP përcaktohet se ankesa mund të parashtrohet vetëm nga pala e interesuar. Duke qenë se operatori ekonomik ankues nuk është palë e interesuar për arsyet e elaboruara si më sipër, ankesa si e tillë duhet të hudhet poshtë si e palejuar nga Paneli Shqyrtues".

Paneli shqyrtues këto deklarime të lartcekura nga AK, i verifikon përmes platformës së e-prokurimit, kështu që është gjetur se OE ankues, pranë AK më datë 10.01.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim duke paraqitur pretendimet e tij/saj ankimore, AK ka nxjerrë vendim më dt. 12.01.2024 dhe ka bërë aprovimin e kërkesës për ri-shqyrtim të OE ankues si tërësisht të bazuar, me çrast njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit është kthyer mbrapa për përmirësim (d.t.th është tërhequr për përmirësim DT). Dhe konform nenit 63.1.3, pika b. të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, AK ka bërë publikimin e njoftimit për korrigjim të gabime, duke përdorur formularin B54 të cilin me dt. 15.01.2024 e ka publikuar në platformën e prokurimit elektronik. Pas publikimit të këtij formularit B54, dhe përmirësimit të DT, operatorit ekonomik lidhur me paknaqësin/papajtueshmërinë e tij me përmirësimin e DT, atëherë ka qenë dasht prap të paraqes kërkesën për ri-shqyrtim konform nenit 108/A, nëse eventualisht AK nuk ju ka përmbajtur përmirësimeve të DT. Në këtë rast, operatori ekonomik nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi pas përmirësimit të DT të cilën shprehimisht e ka paraparë dispozita ligjore e LPP, neni 108/A. Kështu që, në kuptim të nenit 109 të LPP, i cili citon: "1.Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.2.Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji". Si rrjedhojë e kësaj, paneli shqyrtues konform dispozitave të lartcekura detyrohet që ankesën në fjalë ta hedhë si të palejuar dhe si e tillë nuk hynë në trajtim nga ana e këtij Paneli. Në të kundërtën nëse kjo ankesë do të kishte me hy në shqyrtim atëherë do të rezultonte me shkelje të nenit 108/A dhe 109 të LPP nga ana e Panelit.

Rastet kur OE ankues ju kishte lejuar me ardh me ankesë në OSHP në këtë rast, kishte me qenë nëse AK do ja kishte aprovuar kërkesën për ri-shqyrtim vetëm pjesërisht dhe ankuesi do i kishte atakuar vetëm pretendimet ankimore të cilat nuk ja ka aprovuar AK, si dhe rasti tjetër do të kishte me qenë nëse AK e refuzon kërkesën për ri-shqyrtim në tërësi.

Megjithatë, vlenë të potencohet se është fakt notor i njohur për të gjitha palët në procedurë se kjo lëndë është e trajtuar njëherë nga OSHP me Nr. 2023/0843 dhe si i tillë konsiderohet i

ekzekutueshëm për të gjitha palët ne procedure perderisa i njëjti nuk ankimohet pranë gjykatave kompetente, andaj konform nenit 105, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16 i LPP, citon: "*Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".*

Andaj, është në përgjegjësi të AK vendosja e secilit kriter në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, *Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.* Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, *AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.*

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - SRAHEP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: